



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 08.05.2023

Nr: 80

Ora: 12:55

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR.21, DATË 06.05.2023 TË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 08.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

PALË E INTERESUAR: Z. Julian Uzeiri, përfaqësues i bashkisë Konispol

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Arif Tafani, kryetar i bashkisë Belsh; z. Lifter Alla kryetar i bashkisë Bulqizë; z. Andis Salla kryetar i bashkisë Cërrik; z. Armando Subashi kryetar i bashkisë Fier; z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan; z. Klodian Taçe, kryetar i bashkisë Gramsh; z. Redjan Krali, kryetar i bashkisë Kavajë; z. Klement Ndoni, kryetar i bashkisë Këlcyrë; z. Erion Isai, kryetar i bashkisë Kolonjë; z. Shuaip Beqiri, kryetar i bashkisë Konispol;



z. Safet Gjici, kryetar i bashkisë Kukës; z. Pjerin Ndreu, kryetar i bashkisë Lezhë; z. Kastriot Gurra, kryetar i bashkisë Librazhd; zj. Eriselda Sefa, kryetar i bashkisë Lushnje; z. Qerim Ismailaj, kryetar i bashkisë Mallakastër; z. Nuri Belba, kryetar i bashkisë Prrenjas; z. Pali Kolefski, kryetar i bashkisë Pustec; z. Majlinda Bufi, kryetar i bashkisë Roskovec; z. Elton Arbana, kryetar i bashkisë Shijak.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 21 regj., datë 06.05.2023. Në mbledhjen e datës 08.05.2023, ora 12:55, pas relatimit të z. Elvis Çefa, u konstatua se kërkesa i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 08.05.2023, ora 13:45.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Elvis **ÇEFA** - **Relator**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Koli **BELE** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**